



A.nr.647/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.647/2026, të datës 19.06.2026, të parashtruar nga ankuesi A.H. nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Komuna e Fushë Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.06.2026, nxjerrë, këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.647/2026, e datës 19.06.2026, e parashtruar nga ankuesi A.H.

A r s y e t i m

Ankuesi A.H, (*tutje referuar ankuesi*), më datë 19.06.2026, përmes e-mailit ankesa.kpmsheq@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.647/2026, kundër Vendimit me numër 982 të datës 16.06.2026, të Menaxheres së Personelit të Komunës së Fushë Kosovës, lidhur me refuzimin e aplikacionit në procedurën e pranimit me numër të referencës: RN00019608, për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë Ligjor*, të shpallur nga Komuna e Fushë Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të çështjes ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se Komuna e Fushë Kosovës me datë 20.04.2026, ka shpallur konkursin me numër të referencës: RN00019608, për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë Ligjor*, me afat të aplikimit nga data 21.04.2026-20.05.2026.

Rrjedhimisht, sipas provave të lëndës del se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo, sipas Vendimit me numër 982, të datës 16.06.2026, të Menaxheres së Personelit të Komunës së Fushë Kosovës, të njëjtit i është refuzuar aplikacioni.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit për refuzimin e aplikacionit, pretendon se këshilla juridike sipas Vendimit me numër 982

të datës 16.06.2026 i mohon të drejtën për të kundërshtuar vendimin në këtë fazë të procedurës duke pamundësuar pjesëmarrjen në testim dhe fazat tjera, si dhe pretendon së ka gjithsej 5 vite, 3 muaj e 13 ditë përvojë pune, dhe për të cilat nuk duhet të jetë vendimtare nëse një pjesë e përvojës është realizuar me pagesë ose pa pagesë, por duhet të vlerësohet natyra e punës se kryer, përgjegjësitë e ushtruara dhe përvoja e fituar profesionale. Kërkon që të shqyrtohet ligjshmëria e këshillës juridike sipas Vendimit me numër 982, të datës 16.06.2026, të Menaxheres së Personelit të Komunës së Prishtinës, të konstatoj që plotëson kriterin e përvojës se punës; të urdhërojë rishqyrtimin e aplikacionit dhe përfshirjen në fazat e mëtejme; të sigurojë trajtim të barabartë dhe të paanshëm.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht, nenit 39, paragrafi 12 i cili përcakton se: *“12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”*, si dhe nenit 17 të Rregullores 07/2025 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: *“Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”*, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankuesit e parashtruar më datë 19.06.2026, kundër refuzimit të aplikacionit për pozitën e lartcekur është e parakohshme, ngase, me dispozitat përkatëse ligjore, kandidatja për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtroj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të procedurës së rekrutimit, ndërsa, ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar kundër njoftimit për refuzim të aplikacionit si veprim procedural në fazën e shqyrtimit paraprak. Pra, meqenëse në kohën e parashtrimit të ankesës më datë 19.06.2026, nuk kishte përfunduar procedura e pranimi sipas konkursit me Nr.Ref:RN00019608, rrjedhë se ankesa e ankuesit është e parakohshme dhe për rrjedhojë e njëjta është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në ndërlidhje me nenin 39, paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë si parakohshme e ankesës me numër A.nr.647/2026 nuk mohon të drejtën e ankuesit që të kundërshtoj ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.647/2026

Merlinda RAMAJ

Ardita Haxhnikaj DEMI

Procesmbajtëse

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesi, A.H;*
- *Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Fushë Kosovës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*